



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3431/6 prot

Datë 11.12.2025

V E N D I M
Nr.1839/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-66192-10-22-2025, me objekt “Rikonstruksion i Godinës i të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit: 125,042,240.96 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
- Ankimues:** BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK me NIPT J63229466K, K13001010G dhe adresë: Fshati Suke i siperm, Nr 2, Rruga Strum - Suke, Km 3, Lagjja Zoga, Roskovec, Berat
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.10.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-66192-10-22-2025, me objekt “Rikonstruksion i Godinës i të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit: 125,042,240.96 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.2. Në datën 07.11.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 17.11.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. BOE “COLOMBO” & “AGI KONS”	me vlerë	88,166,818.25	skualifikuar
2. BOE “INERTI” & “NEWGEN” shpk	me vlerë	95,270,849	skualifikuar
3. BOE “Kevin K.” shpk, & “CARA” shpk	me vlerë	98,099,529.34	skualifikuar
4. OE“SAI COMPANY” shpk	me vlerë	103,575,771.85	skualifikuar
5. OE“INA” shpk	me vlerë	105 992 182	skualifikuar
6. BOE “ZZ KONSTRUKSION” & “TOTILA”	me vlerë	117,499,290.50	skualifikuar

II.3.1. Referuar raportit të auditit në SPE, BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK rezulton i skualifikuar për arsye se:

“- BOE, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.6 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT në të cilën është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë: - Punonjes I izolimeve (Hidroizolues) 3 punonjës 2.3.6/1 Për punonjësit automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë: a) kontratë individuale të punës; b) leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftësimi profesional (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohej të figurojnë në listpagesat e shoqërisë). Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” ofertuesi nuk ka deklaruar se disponon stafin teknik sikundër percaktuar në pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik, duke mos deklaruar se disponon: 3 (tre) punonjës me profesion “Punonjes I izolimeve (Hidroizolues)”. Konkretisht, ofertuesi ka deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës (B.B & XH. T) me profilin e kërkuar në DST. KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.”

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 20.11.2025 është publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 26.11.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6129 dhe me nr. 3431/2025 prot., datë 27.11.2025 e BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-66192-10-22-2025, me objekt “Rikonstruksion i Godinës i të IEVP Fushë Krujë”, me

fond limit: 125,042,240.96 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Pergendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3268/1 prot., datë 14.11.2025.

II.7. Me datë 09.12.2025 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin nr.146/2025 datë 05.12.2025 të KSHA i cili u protokollua me tonën me nr. 3431/2 prot., datë 10.12.2025 ku rezulton se ka vendosur pranimin e plotë të saj konkretisht duke argumentuar:

II.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

ARSYETON:

II.1. Lidhur me pretendimin e BOE “2Z KONSTRUKSION” shpk & “TOTILA” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës së tij me arsyen se në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, nuk është deklaruar numri i plotë i punonjësve të kërkuar [...].* KSHA vëren:

Në Nenin 2 “Qëllimi” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. ...”

Në nenin 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim;*
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.*

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja 38 detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;*
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.*

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;*

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja "ç", të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e 39 prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet

hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.”

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “I. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin,

punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në pikën 1 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.”*

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të

ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Në dokumentet Standarte të tenderti, Kapaciteti teknik, pika 2.3.3. është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	1
Teknik IT/Elektronik	2
Hidraulik	3
Elektricitet	4
Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje	2
Punonjes i izolimeve (Hidroizolues)	3
Suvatues	4
Punonjes për dyer dritare	6
Bojaxhi	4
Specialist veshje fasade	4
Shofer	3
Automakinista	1

2.3.6/1 Për punonjesit automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftësie profesionale (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojnë kualifikimin profesional të kërkuar; referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimore dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, datë 20.10.2025, citohet:

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "ç". Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.". Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në "rregjistrat profesionale" të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të jave bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim". Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur, për procedurën e prokurimit objekt ankimit, të rishpallur, konstaton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar ofertën e bashkimit të operatorë lidhur me deklarin në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për punonjësit hidroizolues.

Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, sipas fazave respektive, është kërkuar që operatorët ekonomikë të deklarojnë 3 punonjës të specializuar në fushën e hidroizolimit, sipas pikës 2.3.3. të kriterëve të kualifikimit të dokumenteve të tenderit. Në momentin e dorëzimit të dokumentacionit

për procedurën aktuale (të rishpallur), bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka deklaruar vetëm 2 hidroizolues, fakt ky që nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është konsideruar si mospërbushje e kriterit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se ky rezultat/deklarimi sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka ardhur si pasojë e një gabimi teknik dhe jo si mungesë kapacitetesh apo moskonformitet real me kriteret e kualifikimit përcaktuar sipas dokumenteve të tenderit. Në procedurën e mëparshme, e cila është anuluar nga autoriteti kontraktor, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka deklaruar saktësisht 3 hidroizolues, duke vërtetuar qartë se ai i disponon këta punonjës dhe se struktura teknike e kërkuar është plotësisht e përmbushur.

Fakti sa më sipër, është i rëndësishëm për disa arsye ligjore dhe praktike: Së pari, objekti dhe kriteret e dy procedurave të prokurimit janë të njëjta, konkretisht në procedurën e anuluar dhe në atë të rishpallur kërkohet i njëjti numër dhe profil stafi. Operatorët ekonomikë kanë të njëjtën mundësi dhe detyrim për të përmbushur kriteret dhe në këtë kontekst deklarimi i mëparshëm i 3 (tre) hidroizoluesve është dëshmi e drejtpërdrejtë e përmbushjes reale të kriterit. Pra, ndryshimi në numër është thjesht një pasaktësi në plotësim, jo një ndryshim real në kapacitete, një gabim i natyrës formale dhe jo thelbësore. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, direktivave evropiane në fushën e prokurimit publik si dhe praktikave administrative të Vendimmarjes së Komisionit të Prokurimit Publik konkludohet se kur një operator ekonomik ofertues zotëron kapacitetet e kërkuara dhe këto kapacitete janë të verifikueshme, por deklarimi i tyre është bërë gabimisht, atëherë gabimi mund të sqarohet ose korrigjohet pa cënuar barazinë midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Sipas Direktivës 2014/24/BE, proceset e prokurimit duhet të udhëhiqen nga parimet themelore të së drejtës si: proporcionaliteti, trajtim i barabartë, mungesa e diskriminimit, dhe transparenca. Këto parime janë përcaktuar si bazë për interpretimin dhe zbatimin e të gjitha kërkesave kualifikuese dhe procedurale. Në këtë kuadër, gabimi i kryer nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, deklarimi vetëm i 2 hidroizoluesve në vend të 3, konsiderohet si një gabim thjesht formal, që sipas kësaj direktive nuk mund të çojë në përjashtim të menjëhershëm, kur ofertuesi realisht i përmbush kriteret dhe kur gabimi mund të sqarohet pa cënuar konkurrencën.

Referuar nenit 56/3 të Direktivës 2014/24/BE, u jepet e drejta autoriteteve kontraktore që të kërkojnë sqarime, plotësime ose korrigjime të dokumenteve, kur këto nuk ndryshojnë thelbësisht ofertën dhe nuk japin avantazh të padrejtë. Ky nen thekson qartë që operatorët ekonomikë ofertues nuk duhet të penalizohen për gabime ose mungesa jo thelbësore si dhe autoriteti kontraktor mund dhe duhet të lejojë sqarimin ose plotësimin nëse kapacitetet reale të operatorit janë të verifikueshme.

Ndërsa referuar Nenit 18 të Direktivës 2014/24/BE, sipas të cilit autoritetet kontraktore të zbatojnë masa proporcionale, pra sanksionet dhe vendimet administrative dhe vlerësimet duhet të jenë të arsyeshme dhe jo të tepruara krahasuar me natyrën e shkeljes.

Për sa më sipër interpretuar, përjashtimi/skualifikimi i një operatori ekonomik ofertues realisht i zotëron 3 hidroizolues, vetëm sepse gabimisht ka deklaruar 2 në formulain përmbledhës të

vetëdeklarimit , përbën masë jo proporcionale dhe bie në kundërshtim me këtë nen të Direktivës. Gjithashtu sipas Nenit 59/4 të Direktivës 2014/24/BE, i cili është implementuar dhe interpretuar në Nenin 26, pika 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* të ndryshuar, ku citohet se: *“Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”*, Komisioni i Vlerësimit të ofertave duhet të kishte kërkuar sqarime lidhur me deklaratimet e bëra, duke mbajtur në konsideratë edhe deklaratimet në procedurën e anuluar me të njëjtin objekt, pa cënuar konkurrencën dhe duke respektuar barazinë e pjesëmarrësve.

Akoma më tej, nga praktika administrative e vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht, vendim Nr. 427/2025, vendim Nr. 1488/2025, vendim Nr. 1450/2025, vendim Nr. 1459/2025 etj të cilat cilësojnë përdorimin e instrumentit ligjor të sanskionuar sipas Nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* të ndryshuar ku citohet se : *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:*

- i. *“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. *“Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. *“Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”,* autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik.

Gjithashtu, në mbështetje të Nenit 26, pika 4 të VKM nr. 285/2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* të ndryshuar ku citohet se: *“Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm”*, ky parim nuk është thjesht një dispozitë teknike, por një mekanizëm i synuar për të garantuar lehtësimin administrativ, shmangien e barrës së panevojshme dokumentare dhe ruajtjen e një gare të barabartë dhe efektive. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në një interpretim të përkufizimit ligjor të sipërcituar konsideron që në procedurën e mëparshme, e cila u anulua nga autoriteti kontraktor, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka dorëzuar formularët e vetëdeklarimit, ku janë deklaruar saktësisht 3 punonjës të specializuar në hidroizolim, siç kërkohej nga kriteret e kapacitetit teknik. Ky dokument është zyrtar, është depozituar në një proces identik prokurimi dhe pasqyron kapacitetin real teknik të operatorit. Në procedurën e rishpallur, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka dorëzuar një tjetër formular vetëdeklarimi, në të cilin, për shkak të një pasaktësie teknike, janë deklaruar vetëm 2 hidroizolues. Kjo pasaktësi nuk reflekton gjendjen reale të kapaciteteve të operatorit, nuk krijon ndonjë avantazh apo deformim të

Në këtë kontekst, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka pasur në dispozicion dokumentin e saktë të mëparshëm, ka pasur prova/indicie që operatori plotëson kriterin për 3 hidroizolues dhe mund të konsideronte që pasaktësia aktuale nuk ka ndikim në kapacitetin teknik. Për këtë arsye, pasaktësia e deklaruar nuk mund të trajtohet si mangësi thelbësore, por vetëm si formalitet i korrigjueshëm, sepse informacioni real ka qenë gjithmonë në posedim të autoritetit.

Për më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës argumentoi momentin procedural aktualisht të përfunduar, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përdorimin e instrumentit të kërkesës për sqarim. Gjithashtu, ankimuesi në kuadër të mbështetjes së pretendimeve të tij, bashkëlidhur ka paraqitur të gjithë dokumentacionin mbështetës për punonjës in hidroizolues të cilin e ka deklaruar në procedurën e prokurimit të anuluar në plotësim të numrit 3 (tre) të kërkuar dhe nuk ka arritur ta deklarojë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të procedurës së prokurimit të rishpallur. Pra, KSHA konsideron se është e rëndësishme të theksohet se, ndonëse në formularin e vetëdeklarimit të dorëzuar në procedurën e rishpallur ka ndodhur një pasaktësi teknike, duke u deklaruar vetëm 2 punonjës në vend të 3, ky devijim është formal, jo thelbësor, dhe nuk përfaqëson gjendjen reale të kapaciteteve teknike të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Për ta sqaruar këtë situatë dhe për të shmangur çdo keqinterpretim, ankimuesi ka bashkëlidhur dokumentacion të plotë, të verifikueshëm dhe të vlefshëm, ku përfshihet edhe dokumenti i procedurës së mëparshme të anuluar, ku punonjësi i tretë është deklaruar korrekt dhe i pranishëm në listën e stafit teknik.

Bashkëlidhur ankesës, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur:

- formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në procedurën e anuluar ku rezultoi i deklaruar edhe punonjësi hidroizolues i tretë.
- kontratën individuale të punës për hidroizoluesin e pa deklaruar, të tretë, me inicialet A.C, datë 30.9.2024
- Listapagesat përkatëse ku figuron i punësuar në mënyrë të pandërprerë punonjësi hidroizolues me inicialet A.C
- Certifikatat e kualifikimit, sigurimi teknik.

Këto dokumente krijojnë një zinxhir provues të plotë dhe koherent që demonstroi se bashkimi i operatorëve ekonomikë ofertues realisht ka në dispozicion 3 punonjës të kualifikuar për hidroizolim, në përputhje me kërkesat ligjore. Në këtë mënyrë faktohet se, punonjësi i tretë hidroizolues, i padeklaruar është pjesë e stafit të përhershëm, ka qenë i deklaruar saktë në procedurën e parë, e cila më pas u anulua; vazhdon të jetë i punësuar dhe aktiv edhe në momentin e rishpalljes së tenderit; dhe dokumentet provuese e vërtetojnë këtë gjendje të pandryshuar. Pra, ky nuk është një punonjës i përfshirë artificialisht pas faktit, konkretisht formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, nuk është një person i shtuar rishtazi dhe as një përpjekje për të ndryshuar gjendjen reale. Ky punonjës ka qenë gjithmonë pjesë e stafit/personelit, dhe mungesa e emrit të tij në deklarin e procedurës së prokurimit të rishpallur është thjesht gabim teknik, një mospërputhje formale dhe jo një mangësi faktike.

Lidhur me vlerën juridike të dokumenteve të dorëzuara bashkëlidhur ankesës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se nuk e ndryshojnë gjendjen faktike por e konfirmojnë atë. Këto dokumente janë burime zyrtare, janë të datuara shumë para procedurës së rishpallur, nuk janë prodhuar për të justifikuar pasaktësinë dhe vërtetojnë vazhdimësinë e punësimit të 3 hidroizoluesve. Në këtë mënyrë, ato jo vetëm shërbejnë si prova, por si prova të qëndrueshme që reflektojnë gjendjen faktike të pandryshuar të operatorit.

Si përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, duke vendosur një balancë midis formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe provave faktike të paraqitura bashkëlidhur ankesës merr në konsideratë këto të fundit si dëshmi e përmbushjes së kriterit teknik, pika 2.3.3, përcaktuara sipas dokumenteve të tenderit. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, siç e përcaktojnë qartë si legjislacioni kombëtar, ashtu edhe ai evropian, është një instrument formal administrativ me funksion thjesht paraprak, që përmbledh në mënyrë sintetike informacionin e nevojshëm për të kaluar fazën e parë të vlerësimit. Në këtë kontekst, pasaktësia e ndodhur në vetëdeklarimin e procedurës së rishpallur, deklarimi i vetëm dy hidroizoluesve, është një gabim formal-administrativ, i cili nuk ka asnjë ndikim real mbi kapacitetin teknik të operatorit. Ky gabim nuk ndryshon gjendjen faktike dhe as nuk krijon pasoja materiale që të ndikojnë në aftësinë e ofertuesit për të përmbushur objektin e kontratës. Kjo është arsyeja pse Direktiva 2014/24/BE e trajton vetëdeklarimin si dokument paraprak dhe jo përfundimtar, duke i dhënë autoritetit kontraktor të drejtën dhe detyrimin të kërkojë sqarime dhe korrigjime kur informacioni real ekziston dhe është i verifikueshëm. Nga ana tjetër, provat faktike të paraqitura bashkëlidhur ankesës, dokumentacioni i cituar më lart, përbën bazën materiale dhe juridike të vërtetësisë së kapacitetit teknik. Mbi të gjitha, paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të procedurës së anuluar me të njëjtin objekt prokurimi, ku punonjësi i tretë është deklaruar në mënyrë të rregullt, tregon pa mëdyshje se ankimesi jo vetëm që i ka plotësuar kriteret, por i ka deklaruar ato saktë dhe në kohë, përpara se të ndodhte pasaktësia formale në procedurën e rishpallur.

Në kuptimin ligjor, realiteti material, faktik mbizotëron mbi mospërputhjet formale, sidomos kur këto të fundit nuk prekin barazinë e pjesëmarrësve dhe nuk dëmtojnë konkurrencën. Kjo është edhe arsyeja që Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në ushtrim të kompetencës së tij bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, në koherencë me vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, në referencë me direktivat evropiane dhe precedentet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE /CJEU), do t'i japë përparësi provave faktike mbi një pasaktësi të vetme formale në vetëdeklarim.

Natyrë e këtij rasti, pretendimet e paraqitura për procedurën e prokurimit objekt ankimit, një pasaktësi formale në vetëdeklarim, lidhur me numrin e punonjësve hidroizolues, e korrigjuar nga prova të plota dhe të verifikueshme, në momentin procedural dhe ligjor të ushtrimit të së drejtës së ankimit, është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së ku është përcaktuar qartë se parimet e proporcionalitetit, sigurimit të konkurrencës dhe mosdiskriminimit kërkojnë që një ofertues të mos përjashtohet vetëm për shkak të një gabimi formal, kur kapaciteti real teknik ekziston dhe është i dokumentuar.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave citon se qëllimi përfundimtar i çdo procedure prokurimi është realizimi i saktë, cilësor dhe i suksesshëm i punimeve sipas kontratës respektive. Procesi i

prokurimit publik është një mekanizëm për të garantuar që autoriteti kontraktor zgjedh operatorin që ka aftësinë reale për të kryer punimet. Referuar vlerësimit të kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përderisa bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka arritur të plotësojë të gjitha kërkesat ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të përcaktuara në kriteret kualifikuese të dokumenteve të tenderit, mangësia formale e konstatuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, e cila është provuar dhe korrigjuar me dokumente zyrtare bashkëlidhur ankesës, nuk çënon kapacitetin teknik real të ankimesit për të kryer me sukses punimet e kontratës objekt ankimesi.

Për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ZZ KONSTRUKSION” shpk & “TOTILA” shpk
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.9. Informacionin e mësipërm për shqyrtimin e ankesës autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr. 3431/3 prot., datë 11.12.2025.

II.10. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 *te lex specialis* në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me datë 09.12.2025 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin nr.146/2025 datë 05.12.2025 të KSHA i cili u protokollua me tonën me nr. 3431/2 prot., datë 10.12.2025 ku rezulton se ka vendosur pranimin e plotë të saj konkretisht duke argumentuar:

II.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

ARSYETON:

II.1. Lidhur me pretendimin e BOE “2Z KONSTRUKSION” shpk & “TOTILA” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për s’kualifikimin e ofertës së tij me arsyen se në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, nuk është deklaruar numri i plotë i punonjësve të kërkuar [...].* KSHA vëren:

Në Nenin 2 “Qëllimi” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. ...”

Në nenin 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim;*
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.*

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja 38 detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;*
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.*

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;*

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja "ç", të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e 39 prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet

hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.”

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “I. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin,

punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në pikën 1 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.”*

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të

ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Në dokumentet Standarte të tenderti, Kapaciteti teknik, pika 2.3.3. është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	1
Teknik IT/Elektronik	2
Hidraulik	3
Elektricitet	4
Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje	2
Punonjes i izolimeve (Hidroizolues)	3
Suvatues	4
Punonjes për dyer dritare	6
Bojaxhi	4
Specialist veshje fasade	4
Shofer	3
Automakinista	1

2.3.6/1 Për punonjesit automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftësie profesionale (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojnë kualifikimin profesional të kërkuar; referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimore dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, datë 20.10.2025, citohet:

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "ç". Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuar në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.". Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në "rregjistrat profesionale" të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të jave bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim". Bazuar në këto elementet e struktura të kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjesve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur, për procedurën e prokurimit objekt ankimit, të rishpallur, konstaton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar ofertën e bashkimit të operatorë lidhur me deklarin në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për punonjësit hidroizolues.

Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, sipas fazave respektive, është kërkuar që operatorët ekonomikë të deklarojnë 3 punonjës të specializuar në fushën e hidroizolimit, sipas pikës 2.3.3. të kriterëve të kualifikimit të dokumenteve të tenderit. Në momentin e dorëzimit të dokumentacionit

për procedurën aktuale (të rishpallur), bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka deklaruar vetëm 2 hidroizolues, fakt ky që nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është konsideruar si mospërbushje e kriterit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se ky rezultat/deklarimi sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka ardhur si pasojë e një gabimi teknik dhe jo si mungesë kapacitetesh apo moskonformitet real me kriteret e kualifikimit përcaktuar sipas dokumenteve të tenderit. Në procedurën e mëparshme, e cila është anuluar nga autoriteti kontraktor, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka deklaruar saktësisht 3 hidroizolues, duke vërtetuar qartë se ai i disponon këta punonjës dhe se struktura teknike e kërkuar është plotësisht e përmbushur.

Fakti sa më sipër, është i rëndësishëm për disa arsye ligjore dhe praktike: Së pari, objekti dhe kriteret e dy procedurave të prokurimit janë të njëjta, konkretisht në procedurën e anuluar dhe në atë të rishpallur kërkohet i njëjti numër dhe profil stafi. Operatorët ekonomikë kanë të njëjtën mundësi dhe detyrim për të përmbushur kriteret dhe në këtë kontekst deklarimi i mëparshëm i 3 (tre) hidroizoluesve është dëshmi e drejtpërdrejtë e përmbushjes reale të kriterit. Pra, ndryshimi në numër është thjesht një pasaktësi në plotësim, jo një ndryshim real në kapacitete, një gabim i natyrës formale dhe jo thelbësore. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, direktivave evropiane në fushën e prokurimit publik si dhe praktikave administrative të Vendimmarjes së Komisionit të Prokurimit Publik konkludohet se kur një operator ekonomik ofertues zotëron kapacitetet e kërkuara dhe këto kapacitete janë të verifikueshme, por deklarimi i tyre është bërë gabimisht, atëherë gabimi mund të sqarohet ose korrigjohet pa cënuar barazinë midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Sipas Direktivës 2014/24/BE, proceset e prokurimit duhet të udhëhiqen nga parimet themelore të së drejtës si: proporcionaliteti, trajtim i barabartë, mungesa e diskriminimit, dhe transparenca. Këto parime janë përcaktuar si bazë për interpretimin dhe zbatimin e të gjitha kërkesave kualifikuese dhe procedurale. Në këtë kuadër, gabimi i kryer nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes, deklarimi vetëm i 2 hidroizoluesve në vend të 3, konsiderohet si një gabim thjesht formal, që sipas kësaj direktive nuk mund të çojë në përjashtim të menjëhershëm, kur ofertuesi realisht i përmbush kriteret dhe kur gabimi mund të sqarohet pa cënuar konkurrencën.

Referuar nenit 56/3 të Direktivës 2014/24/BE, u jepet e drejta autoriteteve kontraktore që të kërkojnë sqarime, plotësime ose korrigjime të dokumenteve, kur këto nuk ndryshojnë thelbësisht ofertën dhe nuk japin avantazh të padrejtë. Ky nen thekson qartë që operatorët ekonomikë ofertues nuk duhet të penalizohen për gabime ose mungesa jo thelbësore si dhe autoriteti kontraktor mund dhe duhet të lejojë sqarimin ose plotësimin nëse kapacitetet reale të operatorit janë të verifikueshme.

Ndërsa referuar Nenit 18 të Direktivës 2014/24/BE, sipas të cilit autoritetet kontraktore të zbatojnë masa proporcionale, pra sanksionet dhe vendimet administrative dhe vlerësimet duhet të jenë të arsyeshme dhe jo të tepruara krahasuar me natyrën e shkeljes.

Për sa më sipër interpretuar, përjashtimi/skualifikimi i një operatori ekonomik ofertues realisht i zotëron 3 hidroizolues, vetëm sepse gabimisht ka deklaruar 2 në formulain përmbledhës të

vetëdeklarimit, përbën masë jo proporcionale dhe bie në kundërshtim me këtë nen të Direktivës. Gjithashtu sipas Nenit 59/4 të Direktivës 2014/24/BE, i cili është implementuar dhe interpretuar në Nenin 26, pika 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* të ndryshuar, ku citohet se: *“Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”*, Komisioni i Vlerësimit të ofertave duhet të kishte kërkuar sqarime lidhur me deklaratimet e bëra, duke mbajtur në konsideratë edhe deklaratimet në procedurën e anuluar me të njëjtin objekt, pa cënuar konkurrencën dhe duke respektuar barazinë e pjesëmarrësve.

Akoma më tej, nga praktika administrative e vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht, vendim Nr. 427/2025, vendim Nr. 1488/2025, vendim Nr. 1450/2025, vendim Nr. 1459/2025 etj të cilat cilësojnë përdorimin e instrumentit ligjor të sanskionuar sipas Nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285/2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* të ndryshuar ku citohet se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:*

- i. *“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. *“Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. *“Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”,* autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik.

Gjithashtu, në mbështetje të Nenit 26, pika 4 të VKM nr. 285/2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* të ndryshuar ku citohet se: *“Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm”*, ky parim nuk është thjesht një dispozitë teknike, por një mekanizëm i synuar për të garantuar lehtësimin administrativ, shmangien e barrës së panevojshme dokumentare dhe ruajtjen e një gare të barabartë dhe efektive. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në një interpretim të përkufizimit ligjor të sipërcituar konsideron që në procedurën e mëparshme, e cila u anulua nga autoriteti kontraktor, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar formularët e vetëdeklarimit, ku janë deklaruar saktësisht 3 punonjës të specializuar në hidroizolim, siç kërkohej nga kriteret e kapacitetit teknik. Ky dokument është zyrtar, është depozituar në një proces identik prokurimi dhe pasqyron kapacitetin real teknik të operatorit. Në procedurën e rishpallur, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar një tjetër formular vetëdeklarimi, në të cilin, për shkak të një pasaktësie teknike, janë deklaruar vetëm 2 hidroizolues. Kjo pasaktësi nuk reflekton gjendjen reale të kapaciteteve të operatorit, nuk krijon ndonjë avantazh apo deformim të

Në këtë kontekst, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka pasur në dispozicion dokumentin e saktë të mëparshëm, ka pasur prova/indicie që operatori plotëson kriterin për 3 hidroizolues dhe mund të konsideronte që pasaktësia aktuale nuk ka ndikim në kapacitetin teknik. Për këtë arsye, pasaktësia e deklaruar nuk mund të trajtohet si mangësi thelbësore, por vetëm si formalitet i korrigjueshëm, sepse informacioni real ka qenë gjithmonë në posedim të autoritetit.

Për më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës argumentoi momentin procedural aktualisht të përfunduar, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përdorimin e instrumentit të kërkesës për sqarim. Gjithashtu, ankimuesi në kuadër të mbështetjes së pretendimeve të tij, bashkëlidhur ka paraqitur të gjithë dokumentacionin mbështetës për punonjës të hidroizolues të cilin e ka deklaruar në procedurën e prokurimit të anuluar në plotësim të numrit 3 (tre) të kërkuar dhe nuk ka arritur ta deklarojë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të procedurës së prokurimit të rishpallur. Pra, KSHA konsideron se është e rëndësishme të theksohet se, ndonëse në formularin e vetëdeklarimit të dorëzuar në procedurën e rishpallur ka ndodhur një pasaktësi teknike, duke u deklaruar vetëm 2 punonjës në vend të 3, ky devijim është formal, jo thelbësor, dhe nuk përfaqëson gjendjen reale të kapaciteteve teknike të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Për ta sqaruar këtë situatë dhe për të shmangur çdo keqinterpretim, ankimuesi ka bashkëlidhur dokumentacion të plotë, të verifikueshëm dhe të vlefshëm, ku përfshihet edhe dokumenti i procedurës së mëparshme të anuluar, ku punonjësi i tretë është deklaruar korrekt dhe i pranishëm në listën e stafit teknik.

Bashkëlidhur ankesës, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur:

- formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në procedurën e anuluar ku rezultoi i deklaruar edhe punonjësi hidroizolues i tretë.
- kontratën individuale të punës për hidroizoluesin e pa deklaruar, të tretë, me inicialet A.C, datë 30.9.2024
- Listapagesat përkatëse ku figuron i punësuar në mënyrë të pandërprerë punonjësi hidroizolues me inicialet A.C
- Certifikatat e kualifikimit, sigurimi teknik.

Këto dokumente krijojnë një zinxhir provues të plotë dhe koherent që demonstroi se bashkimi i operatorëve ekonomikë ofertues realisht ka në dispozicion 3 punonjës të kualifikuar për hidroizolim, në përputhje me kërkesat ligjore. Në këtë mënyrë faktohet se, punonjësi i tretë hidroizolues, i padeklaruar është pjesë e stafit të përhershëm, ka qenë i deklaruar saktë në procedurën e parë, e cila më pas u anulua; vazhdon të jetë i punësuar dhe aktiv edhe në momentin e rishpalljes së tenderit; dhe dokumentet provuese e vërtetojnë këtë gjendje të pandryshuar. Pra, ky nuk është një punonjës i përfshirë artificialisht pas faktit, konkretisht formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, nuk është një person i shtuar rishtazi dhe as një përpjekje për të ndryshuar gjendjen reale. Ky punonjës ka qenë gjithmonë pjesë e stafit/personelit, dhe mungesa e emrit të tij në deklarin e procedurës së prokurimit të rishpallur është thjesht gabim teknik, një mospërputhje formale dhe jo një mangësi faktike.

Lidhur me vlerën juridike të dokumenteve të dorëzuara bashkëlidhur ankesës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se nuk e ndryshojnë gjendjen faktike por e konfirmojnë atë. Këto dokumente janë burime zyrtare, janë të datuara shumë para procedurës së rishpallur, nuk janë prodhuar për të justifikuar pasaktësinë dhe vërtetojnë vazhdimësinë e punësimit të 3 hidroizoluesve. Në këtë mënyrë, ato jo vetëm shërbejnë si prova, por si prova të qëndrueshme që reflektojnë gjendjen faktike të pandryshuar të operatorit.

Si përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, duke vendosur një balancë midis formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe provave faktike të paraqitura bashkëlidhur ankesës merr në konsideratë këto të fundit si dëshmi e përmbushjes së kriterit teknik, pika 2.3.3, përcaktuara sipas dokumenteve të tenderit. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, siç e përcaktojnë qartë si legjislacioni kombëtar, ashtu edhe ai europian, është një instrument formal administrativ me funksion thjesht paraprak, që përmbledh në mënyrë sintetike informacionin e nevojshëm për të kaluar fazën e parë të vlerësimit. Në këtë kontekst, pasaktësia e ndodhur në vetëdeklarimin e procedurës së rishpallur, deklarimi i vetëm dy hidroizoluesve, është një gabim formal-administrativ, i cili nuk ka asnjë ndikim real mbi kapacitetin teknik të operatorit. Ky gabim nuk ndryshon gjendjen faktike dhe as nuk krijon pasoja materiale që të ndikojnë në aftësinë e ofertuesit për të përmbushur objektin e kontratës. Kjo është arsyeja pse Direktiva 2014/24/BE e trajton vetëdeklarimin si dokument paraprak dhe jo përfundimtar, duke i dhënë autoritetit kontraktor të drejtën dhe detyrimin të kërkojë sqarime dhe korrigjime kur informacioni real ekziston dhe është i verifikueshëm. Nga ana tjetër, provat faktike të paraqitura bashkëlidhur ankesës, dokumentacioni i cituar më lart, përbën bazën materiale dhe juridike të vërtetësisë së kapacitetit teknik. Mbi të gjitha, paraqitja e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të procedurës së anuluar me të njëjtin objekt prokurimi, ku punonjësi i tretë është deklaruar në mënyrë të rregullt, tregon pa mëdyshje se ankimesi jo vetëm që i ka plotësuar kriteret, por i ka deklaruar ato saktë dhe në kohë, përpara se të ndodhte pasaktësia formale në procedurën e rishpallur.

Në kuptimin ligjor, realiteti material, faktik mbizotëron mbi mospërputhjet formale, sidomos kur këto të fundit nuk prekin barazinë e pjesëmarrësve dhe nuk dëmtojnë konkurrencën. Kjo është edhe arsyeja që Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në ushtrim të kompetencës së tij bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, në koherencë me vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, në referencë me direktivat evropiane dhe precedentet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE /CJEU), do t'i japë përparësi provave faktike mbi një pasaktësi të vetme formale në vetëdeklarim.

Natyrë e këtij rasti, pretendimet e paraqitura për procedurën e prokurimit objekt ankimit, një pasaktësi formale në vetëdeklarim, lidhur me numrin e punonjësve hidroizolues, e korrigjuar nga prova të plota dhe të verifikueshme, në momentin procedural dhe ligjor të ushtrimit të së drejtës së ankimit, është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së ku është përcaktuar qartë se parimet e proporcionalitetit, sigurimit të konkurrencës dhe mosdiskriminimit kërkojnë që një ofertues të mos përjashtohet vetëm për shkak të një gabimi formal, kur kapaciteti real teknik ekziston dhe është i dokumentuar.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave citon se qëllimi përfundimtar i çdo procedure prokurimi është realizimi i saktë, cilësor dhe i suksesshëm i punimeve sipas kontratës respektive. Procesi i

prokurimit publik është një mekanizëm për të garantuar që autoriteti kontraktor zgjedh operatorin që ka aftësinë reale për të kryer punimet. Referuar vlerësimit të kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përderisa bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka arritur të plotësojë të gjitha kërkesat ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike të përcaktuara në kriteret kualifikuese të dokumenteve të tenderit, mangësia formale e konstatuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, e cila është provuar dhe korrigjuar me dokumente zyrtare bashkëlidhur ankesës, nuk çënon kapacitetin teknik real të ankimesit për të kryer me sukses punimet e kontratës objekt ankimesi.

Për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ZZ KONSTRUKSION” shpk & “TOTILA” shpk
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se : “1.Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 të ligjit të sipërcituar KPP do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-66192-10-22-2025, me objekt “Rikonstruksion i Godinës i të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit: 125,042,240.96 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 146/2025 datë 05.12.2025 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike dhe të dërguar përmes shërbimit postar protokolluar me tonën respektivisht me nr. 3431/2 prot., datë 10.12.2025 dhe nr. 3431/3 prot., datë 11.12.2025.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar BOE “2Z Konstruksion” SHPK & “Totila” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

